



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

Raporti Përfundimtar tematik të ushtruar në Institucionin “Ministria e Kulturës”  
(MK)

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

## **AUDITIM TEMATIK**

**“MBI VERIFIKIMIN E PROCEDURAVE TË NDJEKURA PËR  
ZBATIMIN E PROJEKTIT ME OBJEKT “PARKU I ARTIT DHE  
RIVITALIZIMI E RIKUALIFIKIMI I TERRITORIT TE ISH-  
KONOSTUDIOS “SHQIPERIA E RE” REALIZUAR NGA  
MINISTRIA E KULTURËS**

**Shtator 2023**

## **PËRMBLEDHJE**

|  |    |
|--|----|
| <b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....   | 3  |
| <b>I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.</b> .....                            | 3  |
| <b>I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.</b> .....                                    | 5  |
| <b>II. Hyrja</b> .....   | 5  |
| 1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:.....  | 5  |
| 2. Qëllimi i auditimit.....  | 5  |
| 3. Identifikimi i çështjes:.....   | 5  |
| 4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen ..... | 6  |
| 5. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:.....   | 6  |
| 6. Kriteret e vlerësimit: .....  | 6  |
| 7. Standardet e Auditimit: .....   | 6  |
| 9. Dokumentimi i rezultateve të auditimit: .....   | 7  |
| 2.1. Informacioni i përgjithshëm:.....   | 7  |
| 2.2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:.....                                   | 8  |
| 2.3. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:.....                            | 8  |
| <b>III. GJETJET DHE REKOMANDIMET</b> .....   | 26 |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Ministrinë e Kulturës, më poshtë e emërtuar “MK”, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura, në lidhje me projektin “Parku i Artit”, i iniciuar nga shkresa e ardhur në KLSH me datë 04.04.2023, protokolluar në KLSH me nr. 141/1 Prot., datë 04.04.2023, kërkesë për informacion nga A.T.C.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në një konkluzion të përgjithshëm në lidhje me auditimin tematik. Gjatë zhvillimit të këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja e funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Grupi i auditimit ka hartuar këtë Raport Përfundimtar auditimi, duke reflektuar edhe komentet e subjektit, sa i takon Projektraportit të auditimit. Rezultatet dhe çështjet kryesore të këtij auditimi janë trajtuar në vijim të raportit përfundimtar, së bashku me konkluzionin e përgjithshëm dhe opinionin e auditimit.

### I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

| NR. | PËRMBLEDHJE E GJETJES   | REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR   | RËNDËSIA | REKOMANDIMI   |
|-----|---|--|----------|---|
| A/1 | <p>Nga auditimi në dokumentacionit fizik dhe elektronik për procedurën e prokurimit me objekt “Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios “Shqipëria e Re”, Tiranë, Faza II”, viti 2022 me fond limit 155,008,461 lekë pa TVSH, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 21.06.2022 (anulluar) dhe në datën 15.08.2022, nuk janë argumentuar kriteret kualifikuese dhe një pjesë e tyre nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kriteret Kualifikuese janë konstatuar në kundërshtim me VKM nr. 425 datë 27.05.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licence për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e Investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore” pika 17. Në pikën 3.5 të DST kërkohet që Operatori Ekonomik për realizimin e punimeve duhet të ketë 1 Arkitekt Peizazhi dhe 1 Inxhinier Pyjesh. Kjo kërkesë nuk është në përputhje me natyrën e kontratës, pasi në hapësirën ku do të zhvillohet projekti nuk është e nevojshme një arkitekt peizazhi, për shkak se projekti është i realizuar nga projektuesi dhe duhet vetëm të zbatohet nga ofertuesi me anë të inxhinierëve zbatues që ai disponon. Për sa i përket kërkesës për një inxhinier pyjesh nuk është e nevojshme dhe në përputhje me natyrën e prokurimit, për shkak se në ambientet e jashtme të Ministrisë së Kulturës nuk ka pyll por thjesht një hapësirë e gjelbër. Në pikën 3.7. kërkohet që Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme (Licence, Kodi III.7.A për “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale</p> | <p><i>Më hollësisht trajtuar në faqe 9-26 të Raportit të Auditimit</i></p> | E lartë  | Ministria e Kulturës, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrin masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendorsja e çdo kriteri duhet të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik. |

|     |   |  |         |   |
|-----|---|--|---------|---|
|     | <p><i>lidhur me pyjet dhe/ose kullotat</i>”), e cila është në kundërshtim me pikën 17 të VKM nr. 425 datë 27.05.2020 për shkak se në hapësirën e gjelbër të Ministrisë së Kulturës, nuk ka as pyje e as kullota që ky kriter të ishte i domosdoshëm për realizimin e procedurës së prokurimit.</p>  |  |         |   |
| B/1 | <p>Midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe operatorit ekonomik "G.L." shpk është lidhur kontrata për punë publike nr. 1962 prot., datë 14.04.2021 me objekt "Rivitalizimi dhe përmirësimi i zonës së gjelbër – Parku i Artit, Ministria e Kulturës" me vlerën e kontratës 356,049 Euro me TVSH. Bazuar në Volumin 2, Seksioni 1, "Forma e Kontratës", në pikën 6 jepen të dhënat e kontratës e cila është e tipi Lump-Sum. Me shkresën nr. 20/1 prot., datë 12.04.2022 operatori ekonomik i është drejtuar mbikëqyrësit, ku kërkohen zëra të rinj punimesh me argumentin e mos parashikimit të zërave të nevojshëm në kontratë dhe përmirësime të projektit të propozuar nga kontraktori. Preventivi i rishikuar i punimeve dhe impakti financiar i volumit të shtuar është në masën 15% të vlerës fillestare në vlerën 5,493,869 lekë. Në kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Neni 49 – Matjet, 49.1. citohet se: Për vlerësimin e kontratave të punës do të zbatohen metodat e mëposhtme:</p> <p>a) Për kontratat me çelësa në dorë, shuma e detyrimit sipas kontratës do të përcaktohet në bazë të ndarjes së çmimit të përgjithshëm të kontratës, ose në bazë të një ndarjeje të shprehur si përqindje e çmimit të kontratës që korrespondon me fazat e përfunduara të punimeve. Kur artikujt shoqërohen me sasi, këto do të jenë sasi fikse për të cilat kontraktori ka paraqitur çmimin e tij të plotë dhe do të paguhen pavarësisht nga sasi të punës së kryer në të vërtetë.</p> <p>Me amendimin nr. 2, nr. 2147 prot., datë 14.04.2022, nga AK dhe OE, është nënshkruar ndryshimi i kontratës duke rishikuar çmimin dhe rritur vlerën e kontratës në shumën 339,608 Euro pa TVSH ose 407,530 Euro me TVSH dhe afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar data 31.05.2022. Pra shtesa e vlerës së kontratës është në shumën 42,900 euro pa TVSH (339,608 euro - 296,708 euro) ose 51,480 Euro me TVSH. Sa më sipër amendimi i kontratës është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës së punimeve nr. 1962 prot., datë 14.04.2021 pasi si, konstatohet është tjetërsuar lloji dhe tipi i kontratës, nga Lump-Sum (çelësa në dorë) në kontratë me çmim njësie, duke përfituar operatori ekonomik një vlerë shtesë prej <b>51,480 Euro me TVSH</b>, të pa ofertuar, argumentuar dhe të pa mbështetur ligjërisht</p> | <p><i>Më hollësisht trajtuar në faqe 9-26 të Raportit të Auditimit</i></p> | E lartë | <p>Ministria e Kulturës, të vlerësojnë e të analizojnë shtesën e kontratës në vlerën <b>51,480 Euro</b> me TVSH e cila rezulton e pa argumentuar, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga sipërmarrësi i punimeve "G.L." sh.p.k.</p> |

### **I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.**

Në përfundim të auditimit të procedurave të ndjekura, në lidhje projektin “Parku i Artit”, të ushtruar në Ministrinë e Kulturës, në zbatim të autorizimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 250/5, datë 09.05.2023, Audituesit e KLSH-së kanë arritur **në konkluzionin**, si më poshtë:

**A1.** Projekti i Artit, nuk ka respektuar parashikimet ligjore të rregullave Europiane të PRAG (In line with EU public procurement regulations), kontratat për punë publike, duke tjetërsuar llojin e kontratës dhe tipi i kontratës, nga Lump-Sum (çelësa në dorë) në kontratë me çmim njësie, duke realizuar një përfitim shtesë të kontraktorit në vlerën 51,480 Euro me TVSH, të pa argumentuar dhe të pa mbështetur ligjërisht.

**A2.** Në procedurën e prokurimit faza II, nuk është respektuar Ligji nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" dhe VKM nr. 425, datë 27.05.2020 "Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore ", i ndryshuar, duke vendosur kritere kualifikuese jo në përputhje me natyrën, vlerën dhe përmasën e kontratës.

## **II. Hyrja**

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të autorizimit nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 250/5, datë 09.05.2023, në Ministrinë e Kulturës, nga data 09.05.2023 deri në datën 18.07.2023, për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura, në lidhje projektin “Parku i Artit”, u krye auditimi në Ministrinë e Kulturës, i iniciuar nga shkresa e ardhur në KLSH me dt. 04.04.2023, protokolluar në KLSH me nr. 141/1 Prot., dt.04.04.2023, kërkesë për informacion nga A.T.C, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.K, përgjegjës grupi;
2. S.Z, anëtar;

### **1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

**Objekti i këtij auditimi** është auditimi i ligjshmërisë së procedurave të ndjekura në lidhje me Projektin “Parku i Artit”.

**2. Qëllimi i auditimit** është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj.

Çështja të cilat do të trajtohen në këtë projekt, lidhet me auditimin mbi vlerësimin e prokurimit dhe zbatimit të kontratave në Pakun e Artit Faza I dhe Faza II.

### **3. Identifikimi i çështjes:**

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi i ligjshmërisë për zbatimin e procedurave prokuruese dhe zbatim të kontratave të ndjekura për projektin “Parku i Artit”, janë parashikuar sipas drejtimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në autorizimin për kryerjen e auditimit tematik nr. Prot., 250/5, datë 09.05.2023.

#### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:**

Ministria e Kulturës është përgjegjëse e linjës dhe institucionet përkatëse të varësisë shqyrtojnë përputhshmërinë me politikat, strategjitë e legjislacionin sektorial dhe kushtet teknike të veçanta për objektin përkatës. Stafit menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **5. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:**

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e detyrimeve kontraktuale, me kuadrin ligjor dhe rregulator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

#### **6. Kriteret e vlerësimit:**

- Programi: Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, 2014-2020. Titulli Projektit: 3C/ PARKU i ARTIT: Cross-border exchange for the development of Cultural and Creative Industries", kodit 354. Rregullat e Prokurimit janë sipas direktivave të Komunitetit Evropian.

- Ligji nr. 27, për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë,

- V.K.M. Nr. 208, datë 10.04.2019 për KKTKM.

- PRAG (In line with EU public procurement regulations), kontratat për punë publike.

- Ligji nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" të ndryshuar.

- VKM nr. 425 datë 27.05.2020 "Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licence për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e Investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore" i ndryshuar.

- Udhëzimin nr. 269 datë 11.08.2020 "Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licence për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve publike në pasuritë kulturore" i ndryshuar.

#### **7. Standardet e Auditimit:**

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

- ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

- ISSAI 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë"

- INTOSAI-P 10 "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e - SAI-t", si dhe INTOSAI-P 30 "Kodi Etikës".

#### **8. Metodatat e auditimit:**

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga subjekti i audituar. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke

përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon:

(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.

1. *Kontroll aritmetik* që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.

1. *Inspektim fizik* dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.

2. *Kontrolli i vlerësimit* për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3-*Verifikimi i transaksioneve* duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.

4-*Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike në subjektin që u auditua.

5-*Raporte dhe informacione* nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.

6-*Pyetësorë* për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

## **9. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve, dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar mbi Projekt Raportin e Auditimit (dërguar MK me shkresën me nr. 4020/2 datë 30.08.2023 prot., në KLSH me nr. 250/9, datë 31.08.2023) u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## **II. PËSHKRIMI AUDITIMIT**

### **2.1. Informacioni i përgjithshëm:**

Auditimi në Ministrinë e Kulturës, u krye në kuadër të autorizimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura në lidhje me projektin “Parku i Artit”. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën ndarjes së projekteve në fazën I dhe fazën II, si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me zbatimin e kontratave dhe prokurimit publik sipas kuadrit rregullator në fuqi. Nga audituesit u administrua dhe vlerësua dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## **2.2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:**

- Objekti i këtij auditimi është rregullshmëria dhe ligjshmëria për procedurat e ndjekura për zbatimin e projektit të Parkut të Artit (Faza I dhe Faza II).
- Qëllimi i auditimit: Auditimi Tematik mbi përputhshmërinë e procedurave administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi. Evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë të natyrës, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vijim.
- Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i procedurave nga Ministria e Kulturës shtrirë sipas drejtimit të autorizimit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me projektin për periudhën nga inicimi i kërkesave.

## **2.3. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:**

Në zbatim të autorizimit nr. 250/5, datë 09.05.2023, u shqyrtua dokumentacioni i procedurave të prokurimit dhe kontratave për Fazën e I dhe Fazën e II.

Projekti i zbatimit "Parku i Artit" përqendrohet në zonën e ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", në verilindje të kryeqytetit dhe sipas parashikimeve të institucionit përgjegjës, Ministria e Kulturës, synon të rivitalizojë atmosferën urbane të gjithë zonës së Kinostudios duke e kthyer atë në një nga polet më të rëndësishme kulturore të qytetit. "Parku i Artit" ndërhyr në Rivitalizimin e parkut përreth Ministrisë së Kulturës, si dhe zonat përreth saj; Aktivizimin e parkut përreth me pavijone kulturore, dhe hapësira për aktivitete në shërbim të publikut dhe qendrës kulturore. Rijetëzimin e godinës fundore të ish-Kinostudios në një "Qendër të re Kulturore". Objekti i ndërhyrjes "*Korpusi Qendror i Ansambllit që përbën ish-Kinostudion (Albafilm Studio)*", është shpallur pasuri kulturore, me status "Monument Kulture" i kategorisë së II-te me Urdhër Nr. 202, datë 24.05.2021. Ky projekt zhvillohet mbi një zonë një pjesë e së cilës është në pronësi të Ministrisë së Kulturës (godina qendrore e korpusit) si dhe pjesa tjetër në pronësi të Albafilm sh.a.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për projektin, e ndarë në 2 faza, ku faza e I-rë, përfshinë ndërhyrjen në infrastrukturë për "*Rivitalizimin dhe Rikualifikimin e Territorit të ish-Kinostudios Shqipëria e Re, Tiranë, Parku i Artit*" në ambientet e Ministrisë së Kulturës dhe Faza II-të përfshinë plotësimin e "*Rikualifikimin e Territorit të ish-Kinostudios Shqipëria e Re, Tiranë, Parku i Artit*", u konstatua:

### **A.1 Faza 1**

Faza e parë e projektit është realizuar nga Drejtoria e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjes dhe Asistencës sipas procedurës si më poshtë vijon:

Programi: Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, 2014-2020. Titulli Projektit: 3C/ PARKU i ARTIT: Cross-border exchange for the development of Cultural and Creative Industries", kodi 354. Rregullat e Prokurimit janë sipas direktivave të Komunitetit Evropian. Buxheti i Projektit: Shuma prej 1,030,000 Euro;

- Buxheti sipas IPA-s (Interreg Fund) (85%) - 875,957 Euro

- Buxheti i Shtetit (State budget) (15%) - 154,581 Euro

Nëpërmjet VKM nr. 711, datë 09.09.2020 "*Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Albafilm" sh.a. Tiranë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Ministrisë së Kulturës është bërë transferimi i 100% të aksioneve të kësaj shoqërie tek Ministria e Kulturës.*

Ministria e Kulturës nëpërmjet shkresës nr. 2945 prot, datë 07.06.2021 i kërkon dakortësinë shoqërisë Albafilm për zhvillimin e fazës së I dhe II të këtij projekti si dhe marrjen përsipër të njoftimit të subjekteve qiramarrëse, kontratat e të cilave administrohen nga kjo shoqëri.



Nëpërmjet deklaratës nr. Rep 3822, nr. Kol., 1309 datë 09.06.2021 shoqëria Albafilm sh.a. shpreh dakortësinë për zhvillimin e projektit dhe merr përsipër njoftimin e subjekteve qiramarrëse të cilët ushtrojnë aktivitet në godinat që do të preken nga projekti me objekt "Parku i Artit dhe Rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re" Tiranë, me zhvillues Ministrinë e Kulturës.

- Me urdhrin e Ministrit nr. 264 datë 15.05.2019, ngrihet grupi i punës për përcaktimin e fondit limit dhe për hartimin e projektit të zbatimit me objekt "Parku i Artit dhe Rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re" Tiranë. Grupi i punës përbëhet nga D.K, A.O dhe N.T.

- Me urdhrin e Ministrit nr. 99 datë 19.02.2020, ngrihen njësia e hartimit të dokumentacionit e përbërë nga N.T (zëvendësohet sipas urdherit 56 datë 08.02.2021 me K.Q), A.O dhe B.K. Me këtë urdher ngrihet gjithashtu dhe komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga E.C, H.D dhe D.A, të cilët ndryshohen me urdhrin nr. 56 datë 08.02.2021 me E.K, O.P dhe K.M.

- Termat e Referencës të Parkut të Artit, janë miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) Nr. 207, datë 2 korrik 2020, në mbështetje të Ligjit nr. 27, për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, neni 38, pika 2, VKM nr. 208, datë 10.04.2019 për KKTKM. Projekti Arkitektonik - Projekt Zbatimi për Restaurimin e TV Ballkan dhe Kinema dhe Rivitalizimin e Hapësirave të Gjelbërta, miratuar në KKTKM me vendim Nr. 58, datë 12.02.2021, të Ligjit nr. 27, për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, neni 38, pika 2., V.K.M. Nr. 208, datë 10.04.2019 për KKTKM, Urdhrit Nr. 233, datë 03.07.2020 për miratimin e rregullores së KKTKM, sekretarisë teknike.

Hartimi i DST për zbatimin sipas Paketës së Punës "Infrastructure and Works" sipas rregullave të PRAG (In line with EU publik procurement regulations). Raporti teknik i hartuar në bazë të shtojcës II dhe VKM Nr. 686, datë 29.07.2015, për VNM) dhe hartuar raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projektit. Për shkak të mosmbulimit të këtij projekti me Fonde IPA, nga Ministria e Kulturës u realizua ndarja e punëve në Faza I & Faza II.

Me vendimin e nr. 07 datë 15.04.2021 të Këshillit Kombëtarë të Territorit (KKT), miratohet leja e ndërtimit për objektin "Rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re" Tiranë. Vendimi është dërguar në Ministrinë e Kulturës me shkresën nr. 2381/3 Prot., datë 14.07.2021, nga ana e Agjencia e Zhvillimin të Territorit.

## A.2 Mbi realizimin e procedurave të prokurimit të kontratave Faza I.

Fondi Limit i parashikuar për kontratat :

1. "Restaurimin dhe Adaptimin e TV Ballkan dhe Kinemasë" të territorit të ish - Kinostudios Shqipëria e Re, është 464,000 Euro pa TVSH.

2. "Rivitalizimin dhe përmirësimin e hapësirës së gjelbër" të territorit të ish – Kinostudios Shqipëria e Re, është 300,000 Euro pa TVSH.

| <b>a. Zhvillimi i Procedurës: "Parku i Artit dhe Revitalizimi dhe rikualifikimi i territorit t është Kinostudios "Shqipëria e Re" Tiranë, Faza I</b> |   |  |
|--|---|--|
| <b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b><br>"E hapur" sipas udhëzuesve të Interreg IPA CBC Itali -Shqipëri-Mali i Zi                        | <b>2 Njësia e Prokurimit</b><br>1. N.T (zëvendësohet sipas urdheut 56 datë 08.02.2021 me K.Q)<br>2. A.O<br>3. B.K | <b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b><br>1. E.C<br>2. H.D<br>3. D.A, të cilët ndryshohen me urdhrin nr 56 datë 08.02.2021 me E.K, O.P dhe K.M |
| <b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b><br>1. 464,000 euro<br>2. 300,000 euro  | <b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b><br>1. <b>458,297 euro, Përfaqësues I BOE A.</b><br>2. <b>296,708 euro, G.L</b> | <b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b><br>5,703 euro ose zbritur 98.7 % nga F.L<br>3,292 euro ose zbritur 98.9% nga F.L.                  |
| <b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b><br>Data 08.04.2021   | <b>8. Burimi Financimit</b><br>Interreg IPA CBC Itali -Shqipëri-Mali i Zi   | <b>9. Operatorët Ekonomike</b><br>a) Pjesëmarrës në tender Numër 1 OE<br>b) S'kualifikuar 0 OE,  |

|  |                     |
|--|---------------------|
| 7/2 Kohëzgjatja e kontratës:<br>6 muaj | c) Kualifikuar 1 OE |
|--|---------------------|

a. Me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm nr. 1055/1, 1055/2, 1055/3 Prot., datë 01.03.2021, u drejtohet operatorëve G.L, G dhe E.K për të paraqitur ofertat e tyre në lidhje me procedurën me objekt "*Rivitalizimin dhe përmirësimin e hapësirës së gjelbër*" të territorit të ish – Kinostudios Shqipëria e Re. Referuar rregullores së deleguar të BE- së nr. 1268/2, përcaktohet se për fondet deri 300,000 euro pa TVSH, realizohen me procedurë ftesë për ofertë. KVO ka kryer vlerësimin e ofertave në datë 01.04.2021, ku kanë marrë pjesë 3 operator ekonomik me të dhënat si më poshtë:

| Nr. | OE   | Pikët teknike | Oferta Ekonomike | Pikët Totale |
|-----|------|---------------|------------------|--------------|
| 1   | G    | 83.71         | 351,898          | 84.32        |
| 2   | G.L  | 88            | 296,708          | 100          |
| 3   | E. K | 73.1          | 337,538          | 87.90        |

Kontrata për zhvillimit e procedurës me objekt "*Rivitalizimin dhe përmirësimin e hapësirës së gjelbër*" të territorit të ish – Kinostudios Shqipëria e Re, është një kontratë sipas modelit Lump Sum.

***Nga auditimi i dokumentacioneve të vëna në dispozicion të operatorit të shpallur ftues G.L konstatohet:***

Oferta ekonomike rezulton e pasaktë ***duke mos vendosur çmimet në të gjitha zërat e preventivit.*** Rreth 1/3 e zërave të preventivit u mungon oferta e çmimeve përkatëse. ***Vlera në total e çmimeve të ofertuar në 2/3, rezulton sa vlera e ofertës që është shpallur fitues.*** Oferta ka rezultuar me gabime dhe të paplotësuara me çmime por nuk është s'kualifikuar nga KVO, për shkak të kontratës çmim total. *Nga KVO nuk janë kërkuar sqarime ose argumentime për këtë fakt të cilat më pas kanë sjellë veprime në kundërshtim me kontratën gjatë ekzekutimit të punimeve.*

b. Në lidhje me objektin e prokurimit "*Restaurimin dhe Adaptimin e TV Ballkan dhe Kinemasë*" të territorit të ish - Kinostudios Shqipëria e Re, me fond limit 464,000 euro pa TVSH, referuar rregullores së delegacionit të BE- së nr. 1268/2 është bërë publikimi në faqen e MK dhe në gazeta lokale. KVO ka kryer vlerësimin e ofertave në datë 08.04.2021, ku kanë marrë pjesë 3 operator ekonomik me të dhënat si më poshtë:

| Nr. | OE             | Pikët teknike | Oferta Ekonomike | Pikët Totale |
|-----|----------------|---------------|------------------|--------------|
| 1   | N              | 73.6          | 468,591          | 97.8         |
| 2   | BOEP, N.P.A, C | 100           | 458,297          | 100          |
| 3   | L.C            | 80.8          | 466,921          | 98.1         |

Në zbatim të projektit është implementuar edhe Paketa e Punës për Fazën e I-rë, që do të mbulohet nga programi IPA Interreg IT-AL-MN për ndërhyrjen në infrastrukturë për "*Rivitalizimin dhe Rikualifikimin e Territorit të ish- Kinostudios Shqipëria e Re, Tiranë, Parku i Artit*" në ambientet e Ministrisë së Kulturës në vlerë totale të investimit prej 797,906 euro. Bazuar Manualit të Procedurave PRAG është vijuar me procedurat e prokurimit dhe janë lidhur dy kontratat e punës si më poshtë vijon:

- Kontratë nr. 1962 prot, datë 14.04.2021, amenduar sipas shtojcës I me nr. 1962/1 prot., datë 17.12.2021, amenduar sipas shtojcës II me nr. 2147 prot., date 14.04.2022 për "*Rivitalizimin dhe përmirësimin e hapësirës së gjelbër*" me operator ekonomik "*G.L*"; me vlerë **296,708 Euro pa TVSH.**

- Kontratë nr. 2092 prot., datë 20.04.2021, amenduar sipas shtojcës I me nr. 2092/2 prot., datë 17.12.2021 për "Restaurimin dhe Adaptimin e TV Ballkan dhe Kinemasë" të territorit të ish - Kinostudios Shqipëria e Re, me operator ekonomik "Joint - Venture - Consortium: P & N.P.A & C"; me vlerë **458,297 Euro pa TVSH**.

- Kontrata supervizorit nr. 2030 prot., datë 16.04.2021, amenduar sipas shtojcës I me nr. 2376 prot., datë 27.04.2022 me operator ekonomik "G.L.A"; me vlerë **10,000 Euro pa TVSH**.

| Nr.    | Objekti   | Operatori Ekonomik | Oferta Euro | Shtesa e Kontratës Euro |
|--------|---|--------------------|-------------|-------------------------|
| Faza I | Rivitalizimin dhe përmirësimin e hapësirës së gjelbër | G.L                | 296,708     | 42,900                  |
| Faza I | Restaurimin dhe Adaptimin e TV Ballkan dhe Kinemasë   | N.P.A              | 458,297     | 0                       |
| Faza I | Mbikëqyrja  | GL.A               | 10,000      | 0                       |

### A.3 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve faza I.

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "Rivitalizimi dhe përmirësimi i zonës së gjelbër – Parku i Artit, Ministria e Kulturës", viti 2021, konstatohet:

- Rivitalizimi i zonës së gjelbër faza I, përfshin sistemime të jashtme të pjesës së pasme të Ministrisë së Kulturës, me punime gërmimi, shtresash, gjelbërimi, ujitje sipërfaqeve të gjelbërta dhe depozita e ujit. Objekti i kontratës "Rivitalizimi dhe përmirësimi i zonës së gjelbër – Parku i Artit, Ministria e Kulturës" është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 1962 prot., datë 14.04.2021, të lidhur midis Autoritetit Ministrinë e Kulturës, përfaqësuar nga ish-Sekretari i Përgjithshëm E.C dhe operatorit ekonomik "G.L" shpk, përfaqësuar nga administratori K.Z. Vlera e kontratës është **296,708 Euro pa TVSH** ose **356,049 Euro me TVSH**.

Preventivi dhe lloji i kontratës bazuar në Volumin 2, Seksioni 1, "Forma e Kontratës", në pikën 6 jepen të dhënat e kontratës si më poshtë vijon:

|   |             |   | Neni i kontratës KVK |  |
|---|-------------|---|----------------------|--|
| 1 | Çmimi       | Kontrat <b>Lump Sum</b> ose "Çelësa në dorë"  | 49 "Matjet"          | 49.1 "Kjo kontratë është Lump Sum, Pra çelësa në dorë dhe nuk ka matje sasive. Pagesa kryet me %.  |
|   |             | Çmimi   | 48                   | 48.1 Çmimet janë fiksuar dhe nuk do të rishikohen  |
| 2 | Kohëzgjatja | 180 ditë (6 muaj)                             | 34                   | Kohëzgjatja e zbatimit e kontratës është maksimumi 6 muaj nga fillimi i punimeve deri në marrjen në dorëzim por jo më vonë se data 30.12.2021. |
| 3 | Pagesa      | Paradhenie 20 %                               | 46                   |  |
|   |             | Situacion pjesor 1. 50 %, 2. 20 % dhe 3. 10 % | 49,50                |  |

Referuar Volumit 2, seksioni 3 "Kushtet e Veçanta të kontratës" (KVK) citohet:

Këto kushte (KVK) zhvillojnë dhe plotësojnë kushtet e përgjithshme (KPK), që rregullojnë kontratën. Nëse kushtet e veçanta nuk parashikojnë ndryshe, kushtet e përgjithshme mbeten plotësisht të zbatueshme. Numërimi i nenit të kushteve të veçanta nuk është i njëpasnjëshëm, por pason numërimin e kushteve të përgjithshme. Në pikën 3 të kontratës citohet se dokumentet do të konsiderohet se formohet, lexohet dhe interpretohet si pjesë e kësaj kontrate në rendin e mëposhtëm **të përparësisë:**

- Kontrata
- Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK)
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

- Sasitë dhe zbërthimin e detajuar i çmimeve
- Specifikimet teknike dhe/ ose performanca
- Projekti dhe vizatimet
- Tenderi
- Dokumente të tjera ose pjesë të kontratës.

Dokumentet e ndryshme që përbëjnë kontratën, do të konsiderohen si shpjeguese reciproke. Në rast paqartësie ose divergjence, ato që do të mbizotërojnë janë paraqitur në rendin më sipër. Shtesat do të kenë rendin e përparësisë së dokumentit të cilin e ndryshojnë.

- Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 2030 prot., datë 16.04.2021, të lidhur midis Autoritetit Ministrinë e Kulturës, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm E.C dhe operatorit ekonomik "GL.A" shpk, përfaqësuar nga administratori F.SH dhe me numër licence MK. 3546/1. Afati i përfundimit të punimeve sipas kontratës, është përcaktuar sipas përfundimit të punës së kontraktorit të zbatimit.

- Në dosje ndodhen Aktet e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, mbajtur nga palët më datë 22.04.2021. Njoftimet, Procesverbali i fillimit të punimeve dhe akti i piketimit, janë mbajtur më datë 22.04.2021. Me shkresën e kontraktorit datë 17.04.2021, drejtuar AK dhe mbikëqyrësit, njoftohet fillimi i punimeve për Rivitalizimin dhe Rikualifikimin e territorit të Ish-kinostudios Shqipëria e Re. Me shkresën e kontraktorit datë 23.04.2021, pezullohen punimet për shkak të mos vënies në dispozicion të lejes së ndërtimit. Me vendimin e KKT nr. 7 datë 15.04.2021 miratohet leja ndërtimit për objektin. **Ndërkohë** shkresa përcjellëse e Vendimin Nr. 7 datë 15.04.2021, drejtuar MK është me nr. 2381/3 prot., datë 14.07.2021. Në dosje ndodhet procesverbal i fillimit të punimeve datë **16.07.2021**, ku kontrata citon se afati i fundit i realizimit punimeve është 30.12.2021.

- Palët OE "G.L" dhe SP E.C, bien dakord për amendim të kontratës **nr. 1**, nr. 1962/1 prot., datë 17.12.2021, ku palët bien dakord për zgjatje të afatit të punimeve deri më **30.04.2022**. *Nga auditimi i dokumentacionit të venë në dispozicion*, i dosjes teknike dhe korrespondencave midis palëve, nuk gjenden arsyet e zgjatjes së afatit të punimeve dhe një përlllogaritje e re e grafikut të punimeve, i cili u miratua një shtyrje më shumë se gjysma e afatit të kontratës.

- Me shkresën e kontraktorit nr. **20/1 prot., datë 12.04.2022** drejtuar mbikëqyrësit, kërkohen zëra të rinj për shkak të mos parashikimit të zërave të nevojshëm që nuk ishin parashikuar në kontratë dhe përmirësime të projektit të propozuar nga kontraktori. Në kërkesë bashkëlidhen analizat e çmimeve, procesverbali i negocimit të çmimeve nr. 21/2 prot. Datë 14.04.2022 të miratuara nga ish-SP. Urdhër ndryshimi nr. 1, tregon se përgjatë zbatimit të projektit u hasën vështirësi në ndarjen e punimeve sipas fazave. Kontrata e fazës së parë përfshin punime që duhet të ishin në fazën e dytë dhe punimet në fazën e dytë duhet të ekzekutohen në fazën e parë për vënien në eficensë të projektit. Për këtë arsye është kryer analiza e ndryshimet të volumeve me plus minuse në zërat dhe sasitë e kontratës. Pra ky urdhër ndryshimi jep impak në sasi, shtim punimesh dhe vlerën e kontratës.

- Me memon nr. **2026/2 prot., datë 14.04.2022**, të konceptuar nga D.P, të pranuar nga A.M, për dijani E.R, drejtuar ish-sekretares së përgjithshme E.C, mbi kërkesën për ndryshim të impaktit financiar të kontratës me OE "G.L", sqarohet se mbikëqyrësi i punimeve me shkresën nr. 20/1 prot., datë 12.04.2022, janë konstatuar problematika dhe mos përputhje me preventivin fillestar të objektit. Konkretisht në disa kapituj pas verifikimeve të volumeve sipas projektimit, operatori **kërkon miratimin e volumeve të reja** të përfshira në Urdhër ndryshimi. Disa punime nuk do të

ekzekutohen në fazën e parë të kontratës dhe në disa kapituj të tjerë janë vënë re disa mospërputhje të volumeve të kontratës dhe ato që rezultojnë nga ekzekutimi i punimeve si në punimet e gjelbërimit, punimeve kanalizimeve të ujërave të shiut.

Referuar kapitullit 1.8 “*Sistemi i ujitjes*”, punimet e parashikuara në preventiv janë ndarë në dy faza, ku në fazën e parë janë parashikuar disa punime për sistemin e ujitjes, por mungojnë disa zëra të cilat ndikojnë në efikasitetin e sistemit. Artikujt që mungojnë nuk realizojnë dot testimin e sistemit. Duke qenë se fillimi i fazës së dytë të punimeve nuk është tenderuar, bimët e mbjella rrezikojnë të thahen për shkak të mungesës së një sistemi vaditës.

Referuar kapitullit 1.9 “*Punime për dhomën teknike dhe depozitën e ujit*” i cili lidhet me kapitullin 1.8 të sistemit të ujitjes, kërkohet të funksionojë dhoma teknike dhe rezervari i ujit, si një domosdoshmëri edhe për funksionalitetin e sistemit të ujitjes. Në preventivin e kontraktuar janë parashikuar pjesërisht punimet e rezervuarit të ujit duke mos funksionalizuar sistemin deri në fazën e dytë. Për këtë arsye, urdhri i ndryshimit është kërkuar realizimi i nevojshëm për zëra të munguar si hidroizolimi i brendshëm, sistemi i pompimit për ujitje, sistemi i mbrojtjes nga zjarri dhe furnizimi me ujë. Preventivi i rishikuar i punimeve, impakti financiar i volumit të shtuar është në masën 15% të vlerës fillestare në vlerën 5,493,869 lekë. Realizimi i rishikimit është i domosdoshëm dhe ndikon në funksionalitetin e projektit. Këto ndryshime do të kenë ndikim edhe në kohën e përfundimit të projektit deri më datë 31.05.2022.

- Në bazë të rregullores Prag të kushteve përgjithshme të kontratës Volumi 2, seksioni 2, Kushtet e përgjithshme të kontratës **neni 37.8** Amendimi, citohet se fondi rezervë nën paketën e punës është 42,900 Euro. Bashkëlidhur ndodhen tabela krahasuese e volumeve, vizatimet e projektit, kërkesa për ndryshim, negociata në preventivin e rishikuar dhe analizat e çmimeve.

#### **Referuar Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës konstatohet:**

Në kushtet e Përgjithshme të Kontratës, **Neni 49** – Matjet, citohet:

49.1. Për vlerësimin e kontratave të punës do të zbatohen metodat e mëposhtme:

**a)** Për kontratat me çelësa në dorë, shuma e detyrimit sipas kontratës do të përcaktohet në bazë të ndarjes së çmimit të përgjithshëm të kontratës, ose në bazë të një ndarjeje të shprehur si përqindje e çmimit të kontratës që korrespondon me fazat e përfunduara të punimeve. Kur artikujt shoqërohen me sasi, këto do të jenë sasi fikse për të cilat kontraktori ka paraqitur çmimin e tij të plotë dhe do të paguhen pavarësisht nga sasi të e punës së kryer në të vërtetë.

**b)** Për kontratat e çmimit për njësi:

**i.** Shuma e detyrimit sipas kontratës do të llogaritet duke aplikuar tarifën për njësi për sasi të ekzekutuara realisht për artikujt përkatës, në përputhje me kontratën;

**ii.** Sasi të përcaktuara në faturën e sasisë do të jenë sasi të parashikuara të punimeve, të cilat nuk do të merren si sasi reale dhe korrekte të punimeve që do të kryhen nga kontraktori në përmbushje të detyrimeve të tij sipas kontratës;

**iii.** Mbikëqyrësi do të përcaktojë me matje sasi të reale të punimeve të kryera nga kontraktori, dhe këto do të paguhen në përputhje me nenin 50. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kushtet e veçanta, nuk do të bëhen shtesa në artikujt në fletore, përveç si rezultat i një ndryshimi në përputhje me **nenin 37** ose një dispozitë tjetër të kontratës që i jep kontraktorit të drejtën për pagesë shtesë;

**iv.** Mbikëqyrësi, kur kërkon të matet ndonjë pjesë e punimeve, duhet t'i japë njoftim të arsyeshëm kontraktorit që të marrë pjesë ose të dërgojë një agjent të kualifikuar për ta përfaqësuar atë. Kontraktuesi ose agjenti i tij do të ndihmojë mbikëqyrësin në kryerjen e një matjeje të tillë dhe do të japë të gjitha të dhënat e kërkuara nga mbikëqyrësi. Nëse kontraktori nuk merr pjesë, ose nuk e dërgon një agjent të tillë, matja e bërë nga mbikëqyrësi ose e miratuar prej tij do të jetë e detyrueshme për kontraktuesin;

v. punimet do të maten neto, jo me zakone të përgjithshme apo lokale, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë.

49.2. Kur një artikull në kontratë tregohet si "i përkohshëm", shumën e përkohshme e caktuar për të nuk do të merret parasysh në llogaritjen e përqindjeve të përmendura në nenin 37.

Referuar në Kushtet e Përgjithshme të kontratës **neni 37.3.c** citohet:

Nuk kërkohet asnjë urdhër administrativ për të rritur ose ulur sasinë e ndonjë pune kur kjo rritje ose ulje është rezultat i sasisë që tejkalon ose është më e vogël se sa është deklaruar në faturim ose në grafikun e çmimeve, si rezultat i matjes së parashikuar në nenin 49.

- Me amendimin **nr. 2**, nr. 2147 prot., datë 14.04.2022, nga AK dhe OE, nënshkruhet ndryshimi i kontratës duke rishikuar çmimin e kontratës në vlerën 339,608 Euro pa TVSH ose 407,530 Euro me TVSH dhe afati i përfundimit të punimeve përcaktohet më datë 31.05.2022.

Pra shtesa e vlerës së kontratës është në vlerën **42,900 euro** pa TVSH (339,608 euro -296,708 euro) ose **51,480 Euro me TVSH**, në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës së punimeve nr. 1962 prot., datë 14.04.2021.

Referuar sa më sipër, konstatohet se nga AK është tjetërsuar lloji i kontratës dhe tipi i kontratës, nga Lump-Sum (çelësa në dorë) në kontratë me çmim njësie, duke realizuar një përfitim shtesë të kontraktorit në vlerën 51,480 Euro me TVSH, të pa argumentuar dhe të pa mbështetur ligjërisht.

Për analogji referuar edhe legjislacionit Shqiptar VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 39 Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike, Punët publike mund të prokurohen:

**a)** me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuar në projekt - preventiv mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar. Kur punët prokurohen me anë të punimeve me matje, vëllimi i punëve jepet me hollësi dhe përmban të gjitha çmimet dhe përqindjet që autoriteti/enti kontraktor i vlerëson të nevojshme (si për shembull: fondi rezervë, të ardhurat minimale, shpenzimet minimale).

**b)** me kontratë me çelësa në dorë:

**i.** Ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt preventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.

Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

- Procesverbali i përfundimit të punimeve mbajtur nga palët është realizuar më datë **31.05.2022**, sipas amendimeve të realizuara nga palët. Pra puna realizohet në total pas 13 muajsh e 14 ditë, ku janë miratuar vonesat dhe shtyrjet nga palët. Akti i kolaudimit është realizuar më datë 06.06.2022, nga Ark. T. D., me detyrë specialist në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë kulturore. dhe certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim u realizua më datë 09.06.2022. Për veprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punime F.SH, personat në dijeni D.P, A.M, E.R dhe ish-Sekretarja e Përgjithshme E.C.

**2.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "Rivitalizimi dhe Rikualifikimi i TV Ballkan dhe territorit të Ish- kinostudios", viti 2021, konstatohet:

- Rivitalizimi i TV Ballkan përfshin pjesën e pasme të ish-Kinostudios Shqipëria e re, ku përfshin punime ndërtime, punime restaurimi punime hidrosanitare punime mekanike dhe elektrike.

- Objekti i kontratës "Rivitalizimi dhe Rikualifikimi i TV Ballkan dhe territorit të Ish-kinostudios" është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 2092 prot., datë 20.04.2021, të lidhur midis Autoritetit Ministrinë e Kulturës, përfaqësuar nga ish-Sekretari i Përgjithshëm E.C dhe Bashkimi e operatorëve ekonomik "P & N.P.A & C" shpk, përfaqësuar BOE "N.P.A" nga administratori F.A. Vlera e kontratës është 458,297 Euro pa TVSH ose 549,957 Euro me TVSH. Preventivi dhe lloji i kontratës bazuar në Volumin 2, Seksioni 1, "Forma e Kontratës", në pikën 6 jepen të dhënat e kontratës si më poshtë vijon:

|   |             |   | Neni i kontratës KVK |  |
|---|-------------|---|----------------------|--|
| 1 | Çmimi       | Kontrat Lump Sum ose "Celsa në dorë"          | 49 "Matjet"          | 49.1 "Kjo kontratë është Lump Sum, Pra çelësa në dorë dhe nuk ka matje sasive. Pagesa kryet me %.  |
|   |             | Çmimi   | 48                   | 48.1 Çmimet janë fiksuar dhe nuk do të rishikohen  |
| 2 | Kohëzgjatja | 180 ditë (6 muaj)                             | 34                   | Kohëzgjatja e zbatimit e kontratës është maksimumi 6 muaj nga fillimi i punimeve deri në marrjen në dorëzim por jo më vonë se data 30.12.2021. |
| 3 | Pagesa      | Paradhënie 20 %                               | 46                   |  |
|   |             | Situacion pjesor 1. 50 %, 2. 20 % dhe 3. 10 % | 49,50                |  |

- Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 2030 prot., datë 16.04.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Ministrinë e Kulturës, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm E.C dhe operatorit ekonomik "GL.A" shpk, përfaqësuar nga administratori F.SH dhe me numër licence MK. 3546/1.

- Në dosje ndodhen Aktet e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, mbajtur nga palët më datë 22.04.2021. Me shkresën e kontraktorit datë 23.04.2021, drejtuar AK pezullohen punimet për shkak të lejes së ndërtimit. Me shkresën e kontraktorit nr. 2135/3 prot., datë 16.07.2021, njoftohet fillimi i punimeve.

- Palët OE "N.P.A" dhe ish- SP E.C, bien dakord për amendim të kontratës nr. 1, nr. 2092/2 prot., datë 17.12.2021, ku palët bien dakord për zgjatje të afatit të punimeve deri më 30.04.2022. Urdhër ndryshimi nr. 1 ka vetëm impakt në kohë deri më datë 30.04.2022, për shkak se gjatë implementimit të projektit, ashensori i propozuar është hidraulik i cili ka probleme klimaterike në temp. 40 grad dhe është i ngadaltë dhe kërkon mirëmbajtje konstante (nderim vaji). Për këtë arsye është vendosur nga palët ashensor me sistem elektrik që është më i shpejtë (1m/s), me performancë më të lartë dhe nuk ka nevojë për mirëmbajtje të kushtueshme. Procesverbali i përfundimit dhe njoftimi i punimeve mbajtur nga palët është realizuar më datë me nr. 2474 prot., datë 29.04.2022, sipas amendimeve të realizuara nga palët Vlera e punimeve përfundimtare është 458,297 Euro pa TVSH ose 549,957 Euro me TVSH, sipas Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 4020/2 Prot., datë 30.08.2023, "Observacione mbi Projekt Raportin" ardhur në KLSH me shkresë nr. 250/9, datë 31.08.2023 nga MK dhe me shkresë nr. 2327/1 Prot., datë 28.07.2023, "Observacione mbi Projekt Raportin" ardhur në KLSH me shkresë nr. 250/7, datë 31.07.2023, nga ish-sekretares së përgjithshme E.C, E.R, A.M dhe D.P dhe ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

... Në bazë të Manualit të Programit – Zbatimi, sipas Aneksit 4.4. të Menaxhimit Financiar dhe Udhëzimit të FLC (First Level of Control), në veçanti, në Shqipëri, Zyra e Kontrollit të Nivelit

të Parë është subjekti përgjegjës për sistemin e kontrolleve të nivelit të parë për secilin partner të projektit individual të Shqipërisë. ...Janë certifikuar Raportet 3.1, 4.1, 5.1 në vlerë 103,345.76 € dhe njohur edhe nga Autoriteti Menaxhues; në proces certifikimi është Raporti 6.1 në vlerë 742,55.59 € dhe raporti 7.1 në vlerë 22,375.80€, në total 764,731.39 €....

Preventivit i paraqitur nga Studio IRI ka qenë e nënvizuar Faza I dhe Faza II, dhe pas shqyrtimit nga ekipi teknik janë lenë jashtë vijës kufizuese sipas Hartës bashkëlidhur, zërat e Fazës 2 për referencë të mos mbulimit dot me buxhet nga fondet e programit Interreg -IPA. Koncretisht për zërat në kapitujt si më poshtë dhe që janë rikonceptuar dhe vlerësuar gjatë Fazës së Dytë të projektit. Neni 49 shprehimisht nuk ndalon të ndjekësh apo zbatosh Kushtet e Përgjithshme që përmbajnë nenet bazë që rregullojnë fazën pas dhënies së kontratës për kontratat e punës. Ato mund t'i nënshtrohen modifikimit nga kushtet e veçanta që janë pjesë e kontratës dhe që përfshijnë gjithashtu shtesat e nevojshme në kushtet e përgjithshme. Nëpërmjet këtyre shtesave dhe modifikimeve, kushtet e veçanta marrin parasysh lëndën specifike të kontratës si dhe rrethanat specifike të projektit me të cilin lidhet kontrata.

Nga Ministria e kulturës citohet se Mbikëqyrësi është kryesisht përgjegjës për mbikëqyrjen teknike të përditshme të kontratës. Pranon ose refuzon kërkesën e kontraktorit për zgjatjen e periudhës së zbatimit të detyrave (neni 35 i kushteve të përgjithshme), mund të urdhërojë modifikime të punimeve (neni 37 i kushteve të përgjithshme) dhe të vendosë për pezullimin e punimeve (neni 38 i kushteve të përgjithshme). Mbikëqyrësi kërkohet të konsultohet me autoritetin kontraktor përpara se të arrijë në konkluzione për disa çështje specifike që kanë implikime financiare, si p.sh. zgjatja e periudhës së zbatimit të detyrave, modifikimet dhe kërkesat për pagesë shtesë.

Mbikëqyrësi mund të urdhërojë çdo modifikim të çdo pjese të punimeve që është e nevojshme për përfundimin ose funksionimin e duhur të punimeve, me kusht që një modifikim i tillë të mos ndryshojë objektin e kontratës. Nenet 37(2) deri në 37(8) të kushteve të përgjithshme përcaktojnë këto ndryshime dhe procedurat dhe kriteret për realizimin, përpunimin dhe vendosjen e çmimeve të tyre. Këto procedura bazohen në dy parime bazë: së pari, që vetëm mbikëqyrësi, dhe jo autoriteti kontraktor, mund të urdhërojë modifikime dhe së dyti, që modifikimet urdhërohen në formën e urdhrave administrative.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Grupi i auditimit të KLSH, konstaton se shpjegimet e subjektit nuk kanë bazë apo mbështetje ligjore dhe administrative. Në lidhje me certifikimet e Zyrës së Kontrollit mbi fondet dhe projektet sqarojmë se nga grupi i auditimit nuk është trajtuar si çështje apo konstatim. Në lidhje me detyrat e mbikëqyrësit dhe përgjegjësitë e tij, grupi i auditimit sqaron se përgjegjësitë e menaxhimit apo administrimit të fondeve dhe të kontratave janë detyra funksionale/përgjegjësi të Autoritetit Kontraktor. Gjithashtu sqarojmë se nuk ka asnjë evidencë justifikuese dhe as bazë ligjore të re nga ato të trajtuara në Akt konstatim dhe projektraportin e auditimit. Sa më sipër nga ana e grupit të auditimit mbahet i njëjti qëndrim.

**B. Faza e II e projektit** është realizuar nga Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve si më poshtë vijon:

#### **B1. Mbi realizimin e procedurës prokuruese (Procedura e anuluar)**

Objekti i Procedurës: "Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re", Tiranë, Faza II". Fondi Limit: 155,008,461 lekë pa TVSH, nga buxheti i shtetit. Grafiku i Punimeve: 12 muaj. Kuadri Ligjor: Ligjit nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", VKM nr. 425, datë 27.05.2020 "Për procedura e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore ", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 269, datë



11.08.2020 të Ministrit të Kulturës "Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore".

|  |  |  |
|--|--|--|
| <b>a. Zhvillimi i Procedurës:</b> "Parku i Artit dhe Revitalizimi dhe rikualifikimi I territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re" Tiranë, Faza II |  |  |
| <b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b><br>"Hapur Punë"<br>Urdhri nr. 274 datë 18.05.2022  | <b>2 Njësia e Prokurimit</b><br>1. A.K<br>2. A.T<br>3. A.O | <b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b><br>1. N.M<br>2. B.K<br>3. K.GJ  |
| <b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b><br>155,008,461 Lekë pa TVSH  | <b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b>                         | <b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b>  |
| <b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b><br>Data 15.06.2022   | <b>8. Burimi Financimit</b><br>Buxheti i shtetit.          | <b>9. Operatorët Ekonomike</b><br>a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 OE<br>b) S'kualifikuar 3 OE,<br>c) Kualifikuar 0 OE |
| <b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b><br>12 muaj   |  |  |
| <b>10. Ankimime</b><br>AK-s'ka; APP-s'ka ; KPP-s'ka  | <b>11. Përgjigje Ankesës nga AK:</b>                       | <b>12. Përgjigje Ankesës</b>   |

Projekti është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale me Vendim nr. 157, datë 17.05.2022 dhe është dërguar pranë MK, DKPP nëpërmjet shkresës nr. 2782, datë 19.05.2022. Nëpërmjet shkresës nr. 875/1 prot, datë 17.05.2022 IKTK ka dërguar gjithë dokumentacionin e nevojshëm mbi shpalljen pasuri kulturore të godinës së Ministrisë së Kulturës Ish- Kinostudio "Shqipëria e Re" dhe ambienteve përreth saj.

- Me urdhrin e titullarit nr. 274, datë 18.05.2022, fillon procedura e prokurimit me fond limit 155,008,461 lekë pa TVSH, sipas ligjit 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë". Nëpërmjet procesverbalit nr. 2781/6 prot., datë 02.06.2022, Autoritetit Kontraktor miraton dokumentet standarde të konkurrimit publik hartuar nga Njësia e Konkurrimit. Formulari i njoftimit të kontratës dhe publikimi i procedurës është realizuar në faqen e Web-it të [www.kultura.gov.al](http://www.kultura.gov.al). Ministria e Kulturës, për procedurën e prokurimit publik nuk ka ndjekur Vendimin Nr. 45 datë 21.01.2009 të KM "Për kryerjen e procedurave në mënyrë elektronike", pika 1, ku vendoset që të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen me mjete elektronike. Sistemi elektronik u përdor në mënyrë të suksesshme nga Ministritë, Institucione Qendrore, Vendore, të pavarura etj., dhe gjatë vitit 2008, u organizuan trajnime për të gjitha njësitë e qeverisjes. Agjencia e Prokurimit Publik ndër vite ka ofruar dhe vazhdon të ofrojë trajnime apo vendime të konflikteve ligjore. APP-ja ka nxjerrë vazhdimisht udhëzime për realizimin e procedurave në formë elektronike.

- Prokurimi është realizuar në mbështetje të ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" të ndryshuar, VKM nr. 425 datë 27.05.2020 "Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licence për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e Investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore" i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 269 datë 11.08.2020 "Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licence për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve publike në pasuritë kulturore" i ndryshuar.

Kriteret Kualifikuese janë në kundërshtim me VKM nr. 425 datë 27.05.2020 "Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licence për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e Investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore" **pika 17**, ku citohet në mënyrë eksplicite "Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e procedurës. Në çdo rast, Komisioni duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Në pikën 3.5. të DST kërkohet që Operatori Ekonomik për realizimin e punimeve në objektin e kontratës duhet të ketë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me listë pagesa, për periudhën 6 (gjashtë) muajt e fundit, konkretisht si më poshtë:

- 1 Arkitekt, Diplomë, Kontratë Pune, CV, Librezë Pune,
- **1 Arkitekt Peizazhi**, Diplomë (Master Profesional), Kontratë Pune, CV, Librezë Pune
- 1 Inxhinier Mjedisi, Diplomë, Kontratë Pune, CV, Librezë Pune; Minimalisht 5 specialistë të certifikuar për Shërbime Gjellbërimi. Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Minimalisht 1 specialist i certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në kantier. Kontratë Pune, CV, Librezë,
- **1 Inxhinier Pyjesh**, Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve operatori ekonomik duhet të paraqesë: Diploma, Kontrate Pune, CV, Libreze Pune.

**3.7.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme (Licence, Kodi III.7.A për *“Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotat”*).

- Përsa i përket pikës 3.5 të DST kur kërkohen nga AK që ofertuesit duhet të kenë një arkitekt peizazhi dhe një inxhinier pyjesh, këto kërkesa janë në kundërshtim me pikën 17 të VKM nr 425 datë 27.05.2020 për shkak se në hapësirën ku do të zhvillohet projekti nuk është e nevojshme një arkitekt peizazhi për shkak se projekti është i realizuar nga projektuesi dhe duhet vetëm të zbatohet nga ofertuesi me anë të inxhinierëve zbatues që ka, ndërsa për sa i përket kërkesës për një inxhinier pyjesh nuk është e nevojshme dhe në përputhje me natyrën e prokurimit, për shkak se në ambientet e jashtme të Ministrisë së Kulturës *nuk ka pyll por thjesht një hapësirë e gjelbër.*

- Përsa i përket pikës 3.7 të DST kjo kërkesë është në kundërshtim me pikën 17 të VKM nr. 425 datë 27.05.2020 për shkak se në hapësirën e gjelbër të Ministrisë së Kulturës nuk ka as pyje e as kullota që ky kriter të ishte i domosdoshëm për realizimin e procedurës së prokurimit.

Në datë 13.06.2022 është paraqitur një ankesë nga OE, E. K ku kërkonte ndryshimin e disa kriterëve që ishin vendosur nga ana AK. Ato kishin të bënin me kriteret 3.2 , 3.5, 3.7 dhe pikën 3.8. AK i ka kthyer përgjigje në datën 15.06.2022 ku i ka shpjeguar që ankesa duhej të sillej në mënyrën e duhur ose nuk do të pranohej duke i lënë afat deri në datë 16.06.2022 ora 12:00. OE e ka ri sjell ankesën në formën e kërkuar brenda afatit të vendosur nga AK por në datën 17.06.2022 ai ka sjell një kërkesë ku ka informuar AK se është tërhequr nga ankesa për arsyet e tyre objektive. Në datën 21.06.2022 është bërë hapja e ofertave ku ka rezultuar se ka pasur 3 të tilla si më poshtë:

1. BOE “K” shpk me ofertë 147,615,286 lekë pa TVSH
2. BOE “N.P.A” shpk me ofertë 151,936,752 lekë pa TVSH
3. BOE ‘C’ shpk me ofertë 153,995,027 lekë pa TVSH

Në datën 05.07.2022 me memon nr. 3642 Prot., i bëjnë me dije titullarit të institucionit se duhej një asistencë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në lidhje me kriterin 3.12 të kriterëve të veçanta ku është kërkuar një autobot uji. Me shkresën me lëndë “Kërkesë për informacion” me nr. 3642/1 datë 05.07.2022 i është kërkuar DPSHTRR-së informacion për kodet që mbajnë këto mjete dhe kërkesa teknike rreth tyre. Me shkresën me lëndë Kthim përgjigje me nr. 17165/1 Prot., datë 12.07.2022 DPSHTRR-ja i ka kthyer përgjigje institucionit në lidhje me kodet që këto mjete duhet të kenë por jo për kushtet teknike të këtyre cisternave pasi nuk ishte tagër i tyre. Në datë 15.07.2022 me nr. 2781/8 është mbajtur Procesverbali i Vlerësimit ku janë pasqyruar arsyet e s kualifikimit për të 3 OE, si më poshtë:

1. BOE “K” shpk pasi nuk ka përmbushur germën b, pika 1 ; pikën 3.1 ; pikën 3.5 ;
2. BOE “C” shpk pasi nuk ka përmbushur pikën 3.5 ; pikën 3.12 ;

3. BOE “N.P.A” shpk pasi nuk ka përmbushur pikën 3.1 ; pikën 3.6 ; pikën 3.12.

Me memon nr 2781/9 Prot., datë 15.07.2022 informohet titullari për vlerësimin e ofertave nga të cilat janë s kualifikuar të gjitha ofertat dhe që procedura do të anulohet. Me shkresën me lëndë “Njoftim për ofertuesit” me nr. 2781/10 datë 15.07.2022 u është dërguar të gjithë OE pjesëmarrës për t’ju shpjeguar arsyet e s kualifikimit. Ky njoftim u është dërguar secilit OE edhe me anë të email-it. Më datë 21.07.2022 është miratuar nga titullari Raporti përmbledhës i procedurës ku janë pasqyruar të gjitha hapat e ndjekura nga NJVO, ku është vendosur se procedura do të anulohet pasi është pritur afati prej 5 ditësh për ankesa dhe ka rezultuar se te tilla nuk ka pasur. Më datë 21.07.2022 është bërë anulimi i procedurës me anë të shkresës nr. 2781/12 me lëndë “Formulari i Njoftimit të Anulimit” e cila i është dërguar dhe APP me shkresën nr. 2781/13, për tu publikuar në buletin e tyre.

## B2. Mbi realizimin e procedurës prokuruese

| <b>a. Zhvillimi i Procedurës:</b> “Parku i Artit dhe Revitalizimi dhe rikualifikimi I territorit t është Kinostudios “Shqipëria e Re” Tiranë, Faza II |  |   |
|---|--|---|
| <b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b><br>“Procedurë Konkurrimi”<br>Urdhri nr. 471 datë 21.07.2022   | <b>2 Njësia e Prokurimit</b><br>1. A.K<br>2. A.T<br>3. A.O   | <b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b><br>1. N.M<br>2. B.K<br>3. K.GJ   |
| <b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b><br>155,008,461 Lekë pa TVSH   | <b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b><br>144,027,704.7 lekë pa TVSH,<br><i>Përfaqësues I BOE N. P. A shpk</i> | <b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b><br>10,980,757 lekë pa TVSH ose zbritur 92.9 % nga F.L                   |
| <b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b><br>Data 15.08.2022  | <b>8. Burimi Financimit</b><br>Buxheti i shtetit.  | <b>9. Operatorët Ekonomike</b><br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 1 OE<br>b) S’kualifikuar 0 OE,<br>c) Kualifikuar 1 OE |
| <b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b><br>12 muaj  |  |   |
| <b>10.Ankimime</b><br>AK-s’ka; APP-s’ka ; KPP-s’ka  | <b>11. Përgjigje Ankesës nga AK:</b>   | <b>12.Përgjigje Ankesës</b>   |

Referuar urdhrin të konkurrimit publik nr. 471, protokolluar me nr. 3914/1 prot, datë 21.07.2022 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor (Ministria e Kulturës) "Për zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik me objekt "Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re", Tiranë, Faza II", duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi, u caktua procedura konkurruese "Punë", sipas përcaktimeve të lidhjes nr.1 të Udhëzimit nr. 269, datë 11.08.2020 të Ministrit të Kulturës "Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licence për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore", i ndryshuar, me fond limit 155,008,461 leke pa TVSH. Titullari i Autoritetit Kontraktor miratoi dokumentet standarde të konkurrimit publik hartuar nga Njësia e Konkurrimit nëpërmjet procesverbalit nr. 3714/4 prot., datë 21.07.2022.

Kriteret Kualifikuese janë në kundërshtim me VKM nr. 425 datë 27.05.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licence për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e Investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore” pika 17, ku citohet në mënyrë eksplicite “Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e procedurës. Në çdo rast, Komisioni duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Në pikën 3.5. të DST kërkohet që Operatori Ekonomik për realizimin e punimeve në objektin e kontratës duhet të ketë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e

shoqërisë), të vërtetuar me listë pagesa, për periudhën 6 (gjashtë) muajt e fundit, konkretisht si më poshtë:

- 1 Arkitekt, Diplomë, Kontratë Pune, CV, Librezë Pune
- **1 Arkitekt Peizazhi**, Diplomë (*Master Profesional*), Kontratë Pune, CV, Librezë Pune
- 1 Inxhinier Mjedisi, Diplomë, Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Minimalisht 5 specialistë të certifikuar për Shërbime Gjelbërimi. Kontratë Pune, CV, Librezë Pune, Minimalisht 1 specialist i certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në kantier. Kontratë Pune, CV, Librezë,
- **1 Inxhinier Pyjesh**, Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve operatori ekonomik duhet të paraqesë: Diploma, Kontrate Pune, CV, Libreze Pune.

**3.7.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme (Licence, Kodi III.7.A për "*Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotat*").

- Përsa i përket pikës **3.5** të DST kur kërkohen nga AK që ofertuesit duhet të kenë një arkitekt peizazhi dhe një inxhinier pyjesh, këto kërkesa janë në kundërshtim me pikën 17 të VKM nr. 425 datë 27.05.2020 për shkak se në hapësirën ku do të zhvillohet projekti nuk është e nevojshme një arkitekt peizazhi për shkak se projekti është i realizuar nga projektuesi dhe duhet vetëm të zbatohet nga ofertuesi me anë të inxhinierëve zbatues që ka, ndërsa për sa i përket kërkesës për një inxhinier pyjesh nuk është e nevojshme dhe në përputhje me natyrën e prokurimit, për shkak se në ambientet e jashtme të Ministrisë së Kulturës nuk ka pyll por thjesht një hapësirë e gjelbër.

- Përsa i përket pikës **3.7** të DST kjo kërkesë është në kundërshtim me pikën 17 të VKM nr. 425 datë 27.05.2020 për shkak se në hapësirën e gjelbër të Ministrisë së Kulturës nuk ka as pyje e as kullota që ky kriter të ishte i domosdoshëm për realizimin e procedurës së prokurimit.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Më datë 21.07.2022 nëpërmjet shkresës nr. 3714/3, u dërgua për publikim në buletin e njoftimeve publike, formulari i njoftimit të konkurrimit publik, ku si afat kohor për publikimin e kontratës u caktua data 25.07.2022 dhe afati kohor për dorëzimin e ofertave u caktuar data 10.08.2022. Më datë 15.08.2022 u mbajt procesverbali i hapjes së ofertave dhe më datë 25.08.2022 u mbyll procesi i vlerësimit të ofertave, duke kualifikuar si të vlefshme ofertën e paraqitur nga BOE "P" shpk & "N.P.A" shpk & "A.K" sh.p.k. & "M. shpk me vlere 144,027, 704.7 lekë pa TVSH. Më datë 01.09.2022 u dërgua për publikim pranë Agjencisë së Prokurimit Publik Njoftimi i fituesit.

Ministria e Kulturës dhe BOE "P" shpk & "N.P.A" shpk & "A.K" shpk & "M/S" sh.p.k, lidhen ndërmjet tyre kontratën nr. 3914/15 prot., datë 12.09.2022 me objekt "*Parku i Artit, Rivitalizimi dhe Rikualifikimi i Territorit të Ish- Kinostudios " Shqipëria e Re" Tiranë Faza II*". Vlera e kontratës është 144,027,704.7 lekë pa TVSH, me afat 12 muaj.

Kuadri Ligjor: Ligjit nr. 27/2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", VKM nr. 425, datë 27.05.2020 "*Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore*", i ndryshuar, VKM 1125, datë 30.12.2020 "*Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre*", si dhe Udhëzimit nr. 269, datë 11.08.2020 të Ministrisë së Kulturës "*Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licence për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore*". Objekti i Procedurës: "*Mbikëqyrja e Punimeve për objektin "Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re", Tiranë, Faza II*". Fondi Limit:

1,941,517 lekë pa TVSH, nga buxheti i shtetit. Afati i realizimit të shërbimit: Sipas afatit të kontratës së zbatimit.

Më datë 13.09.2022 Drejtorja e Prokurimeve, Koncesioneve dhe Partneriteti ka kërkuar rialokim fondesh për mbikëqyrjen e punimeve për projektin "Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re ", Tiranë, Faza II".

Më datë 17.11.2022 është rialokuar fondi i nevojshëm për zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik me objekt "Mbikëqyrja e Punimeve për objektin e "Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re ", Tirane, Faza II". Njëpërmjet Memos nr. 6406 prot., datë 17.11.2022 ka iniciuar procedurën e prokurimit me objekt: "Mbikëqyrja e Punimeve për objektin e "Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re ", Tiranë, Faza II". Më datë 21.11.2022 u publikuan dokumentet standarde të konkurrimit publik dhe procedura u zhvillua më datë 30.11.2022. Më datë 12.12.2022 u publikua njoftimi i fituesit në buletin e njoftimeve publike ku u shpall fitues Bashkimi i Operatorëve Ekonomike "N.G" shpk & "F.A" shpk me vlerë të ofertuar 1,708,853 lekë pa tvsh . Më datë 14.12.2022 Autoriteti Kontraktor Ministria e Kulturës dhe BOE "N.G" shpk & "F.A" lidhën kontratën e shërbimit me objekt Mbikëqyrja e Punimeve për objektin "Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re", Tiranë, Faza II". Zbatimi i kontratës është në fazë zbatimi dhe sipas grafikut të punimeve duhet të përfundojë në Nëntor 2023.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 4020/4 Prot., datë 30.08.2023, "Observacione mbi Projekt Raportin" ardhur në KLSH me shkresë nr. 250/9, datë 31.08.2023 nga MK dhe me shkresë nr. pa Prot., "Observacione mbi Projekt Raportin" ardhur në KLSH me shkresë nr. 250/8, datë 31.07.2023, nga përfaqësues të MK, A.T, A.O dhe A.K, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

... Çdo projekt i cili parashikon ndërhyrje në pasuritë kulturore kategori I apo e II, baza ligjore së cilës do i nënshtrohen është ligji nr. 27/2018 "Për trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" dhe aktet nën ligjore në zbatim të tij.

...Në lidhje me arkitektin restaurator është një kriter i lidhur pikërisht me bazën ligjore të sipërcituar si dhe me VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 "Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudit të tyre", bazuar në pikën 2, Kreun IV, të VKM.

...Preventivi i punimeve nuk ka ndërhyrje ruajtëse, restauruese dhe mbrojtëse vetëm në shatërvanët para monumentin, ashtu si referohet në aktin e konstatimit të grupit të auditimit, por referuar shkronjës B "Qendra e Artit" të preventivit të punimeve, ka punime instalimi, punime/restaurimi shtresash, punime/restaurimi elektrike në brendësi dhe në fasadën e objektit, punime/restaurime çatie, punime/restaurime fasada e objektit, punime/restaurime solete si dhe punimet/restaurimet e tjera janë për rehabilitimin e zonës e cila është zonë mbrojtëse e objektit ku ndodhen edhe dy shatërvanët, të cilës ligji i jep rëndësi të veçantë.

...Në lidhje me AK që nuk ka detyrim ligjor për të nisur hetim mbi operatorët ekonomikë që paraqesin ankesë dhe më pas tërhiqen prej saj.

... Në lidhje me kërkesën për arkitekt peizazhi sqarohet se, arkitekti i peizazhit nuk bën vetëm projektimin edhe krijimin e hapësirave të jashtme, parqe, kopshte, sipërfaqe të gjelbëruara, por arkitekti i peizazhit ndjek dhe zbatimin e plotë të këtij projekti, kjo është edhe arsyeja pse sipas legjislacionit shqiptar arkitektet licencohen në projektim dhe zbatim bashkë.

.... Në lidhje me Ing. e pyjeve nuk nënkuptohet që ky inxhinier ka lidhje vetëm me pyjet, por me çdo hapësirë të gjelbër mbi tokë, në të cilën ndodhen ose do të vendosen pemë me karakter apo natyrë pyjore.

**Oëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me bazën ligjore të trashëgimisë kulturore, grupi i auditimit sqaron se nuk është cituar mospërputhshmëri në lidhje me përdorimin e procedurës. Në lidhje me arkitektin restaurator, referuar edhe preventivit të projektit ku do të ndërhyhet në ndërhyrje ruajtse, restauruese në fasadën e objektit merret në konsideratë. Në lidhje me ankesën e OE, merret në konsideratë nga grupi i auditimit. Në lidhje me shpjegimet e subjektit për arkitektin e peizazhit, Ing e pyjeve apo shërbimet e ekspertizës së pyjeve nuk kanë bazë apo mbështetje ligjore dhe administrative dhe nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit. Sa më sipër nga ana e grupit të auditimit mbahet i njëjti qëndrim.

|                                  |   |
|----------------------------------|---|
| <p><b>Titulli i gjetjes:</b></p> | <p>Në procedurën e prokurimit “Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios “Shqipëria e Re”, Tiranë, Faza II”, Njësia e Prokurimit ka përcaktuar kriteret kualifikuese jo në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese dhe natyrën e procedurës, duke mos stimuluar dhe mos nxitur konkurrencën në prokurim.</p>  |
| <p><b>Situata:</b></p>           | <p>Nga auditimi në dokumentacionit fizik dhe elektronik për procedurën e prokurimit me objekt “Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios “Shqipëria e Re”, Tiranë, Faza II”, viti 2022 me fond limit 155,008,461 lekë pa TVSH, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 21.06.2022 (anulluar) dhe në datën 15.08.2022, nuk janë argumentuar kriteret kualifikuese dhe një pjesë e tyre nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kriteret Kualifikuese janë në kundërshtim me VKM nr. 425 datë 27.05.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licence për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e Investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore” <b>pika 17</b>, ku citohet në mënyrë eksplicite “Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e procedurës. Në çdo rast, Komisioni duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit për përmbushjen e këtyre kriterëve.</li> <li>- Në pikën 3.5 të DST kërkohet që Operatori Ekonomik për realizimin e punimeve në objektin e kontratës duhet të ketë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me listë pagesa, për periudhën 6 (gjashtë) muajt e fundit, konkretisht si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>1 Arkitekt Peizazhi</b>, Diplomë (Master Profesional), Kontratë Pune, CV, Libreze Pune, <b>1 Inxhinier Pyjesh</b>, Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve operatori ekonomik duhet të paraqesë: Diploma, Kontrate Pune, CV, Libreze Pune.</li> </ul> </li> </ul> <p>Në lidhje me pikën 3.5 të DST kur kërkohen nga AK që ofertuesit duhet të kenë një arkitekt peizazhi dhe një inxhinier pyjesh, këto kërkesa janë në kundërshtim me pikën 17 të VKM nr. 425 datë 27.05.2020, pasi në hapësirën ku do të zhvillohet projekti nuk është e nevojshme një</p> |

|                           |   |
|---------------------------|---|
|                           | arkitekt peizazhi, për shkak se projekti është i realizuar nga projektuesi dhe duhet vetëm të zbatohet nga ofertuesi me anë të inxhinierëve zbatues që ai disponon, ndërsa për sa i përket kërkesës për një inxhinier pyjesh nuk është e nevojshme dhe në përputhje me natyrën e prokurimit, për shkak se në ambientet e jashtme të Ministrisë së Kulturës <i>nuk ka pyll por thjesht një hapësirë e gjelbër</i> . Në pikën 3.7. kërkohet që Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme (Licence, Kodi III.7.A për <i>“Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotat”</i> ). Në lidhje me këtë kërkesë, konstatohet se është në kundërshtim me pikën 17 të VKM nr. 425 datë 27.05.2020 për shkak se në hapësirën e gjelbër të Ministrisë së Kulturës nuk ka as pyje e as kullota që ky kriter të ishte i domosdoshëm për realizimin e procedurës së prokurimit. |
| <b>Kriteri:</b>           | Ligji nr. 27/2018 <i>"Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"</i> , VKM nr. 425, datë 27.05.2020 <i>"Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore "</i> , i ndryshuar.<br>VKM 1125, datë 30.12.2020 <i>"Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre"</i> .   |
| <b>Ndikimi/Efekti:</b>    | Mos argumentim i kritereve kualifikues dhe mos nxitje të pjesëmarrjes në konkurrim  |
| <b>Shkaku:</b>            | Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligji nr. 27/2018 <i>"Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"</i> dhe VKM nr. 425, datë 27.05.2020 <i>"Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore "</i> , i ndryshuar.  |
| <b>Rëndësia:</b>          | E Lartë   |
| <b>Rekomandimi:</b>       | Ministria e Kulturës, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrin masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosija e çdo kriteri duhet të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.   |
| <b>Titulli i gjetjes:</b> | Mos respektim i kushteve të kontratës nga Lump-Sum (çelësa në dorë) në kontratë me çmim njësie, duke realizuar një përfitim shtesë të kontraktorit në vlerën 51,480 Euro me TVSH, të pa argumentuar dhe të pa mbështetur ligjërisht.  |
| <b>Situata:</b>           | Rivitalizimi i zonës së gjelbër faza I, përfshin sistemime të jashtme të pjesës së pasme të Ministrisë së Kulturës, me punime gërmimi, shtresash, gjelbërimi, ujitje sipërfaqeve të gjelbërta dhe depozita e ujit. Objekti i kontratës <i>"Rivitalizimi dhe përmirësimi i zonës së gjelbër – Parku i Artit, Ministria e Kulturës"</i> është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 1962 prot., datë 14.04.2021, të lidhur midis Autoritetit Ministrinë e Kulturës dhe operatorit ekonomik "G.L" shpk. Vlera e   |

kontratës është 356,049 Euro me TVSH. Preventivi dhe lloji i kontratës bazuar në Volumin 2, Seksioni 1, “Forma e Kontratës”, në pikën 6 jepen të dhënat e kontratës e cila është e tipi Lump-Sum.

Palët OE “G.L.” dhe SP E.C., bien dakord për amendim të kontratës nr. 1, nr. 1962/1 prot., datë 17.12.2021, ku palët bien dakord për zgjatje të afatit të punimeve deri më 30.04.2022.

- Me shkresën e kontraktorit nr. 20/1 prot., datë 12.04.2022 drejtuar mbikëqyrësit, kërkohen zëra të rinj për shkak të mos parashikimit të zërave të nevojshëm që nuk ishin parashikuar në kontratë dhe përmirësime të projektit të propozuar nga kontraktori. Në kërkesë bashkëlidhen analizat e çmimeve, procesverbali i negociimit të çmimeve nr. 21/2 prot., datë 14.04.2022 të miratuara nga ish-SP. Urdhër ndryshimi nr. 1, tregon se përgjatë zbatimit të projektit u hasën vështirësi në ndarjen e punimeve sipas fazave. Kontrata e fazës së parë përfshin punime që duhet të ishin në fazën e dytë dhe punimet në fazën e dytë duhet të ekzekutohen në fazën e parë për vënien në eficensë të projektit. Për këtë arsye është kryer analiza e ndryshimet të volumeve me plus minuse në zërat dhe sasi të kontratës. Pra ky urdhër ndryshimi jep impakt në sasi, shtim punimesh dhe vlerën e kontratës.

- Me memon nr. 2026/2 prot., datë 14.04.2022, mbi kërkesën për ndryshim të impaktit financiar të kontratës me OE “G.L.”, sqarohet se mbikëqyrësi i punimeve me shkresën nr. 20/1 prot., datë 12.04.2022, janë konstatuar problematika dhe mos përputhje me preventivin fillestar të objektit. Konkretisht në disa kapituj pas verifikimeve të volumeve sipas projektimit, operatori kërkon miratimin e volumeve të reja të përfshira në Urdhër ndryshimi.

Preventivi i rishikuar i punimeve dhe impakti financiar i volumit të shtuar është në masën 15% të vlerës fillestare në vlerën 5,493,869 lekë. Realizimi i rishikimit është i domosdoshëm dhe ndikon në funksionalitetin e projektit. Këto ndryshime do të kenë ndikim edhe në kohën e përfundimit të projektit deri më datë 31.05.2022. Ndryshimi është mbështetur në bazë të rregullores Prag të kushteve përgjithshme të kontratës Volumi 2, seksioni 2, Kushtet e përgjithshme të kontratës neni 37.8 Amendimi, citohet se fondi rezervë nën paketën e punës është 42,900 Euro. Bashkëlidhur ndodhen tabela krahasuese e volumeve, vizatimet e projektit, kërkesa për ndryshim, negociata në preventivin e rishikuar dhe analizat e çmimeve.

Referuar Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës konstatohet:

Në kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Neni 49 – Matjet, citohet:

49.1. Për vlerësimin e kontratave të punës do të zbatohen metodat e mëposhtme:

**a)** Për kontratat me çelësa në dorë, shuma e detyrimit sipas kontratës do të përcaktohet në bazë të ndarjes së çmimit të përgjithshëm të kontratës, ose në bazë të një ndarjeje të shprehur si përqindje e çmimit të kontratës që korrespondon me fazat e përfunduara të punimeve. Kur artikujt shoqërohen me sasi, këto do të jenë sasi fikse për të cilat



|                 |   |
|-----------------|---|
|                 | <p><u>kontraktori ka paraqitur çmimin e tij të plotë dhe do të paguhet pavarësisht nga sasi e punës së kryer në të vërtetë.</u></p> <p><b>b) Për kontratat e çmimit për njësi:</b></p> <p><b>i.</b> Shuma e detyrimit sipas kontratës do të llogaritet duke aplikuar tarifën për njësi për sasi të ekzekutuara realisht për artikujt përkatës, në përputhje me kontratën;</p> <p><b>ii.</b> Sasi të përcaktuara në faturën e sasisë do të jenë sasi të parashikuara të punimeve, të cilat nuk do të merren si sasi reale dhe korrekte të punimeve që do të kryhen nga kontraktori në përmbushje të detyrimeve të tij sipas kontratës;</p> <p><b>iii.</b> Mbikëqyrësi do të përcaktojë me matje sasi të punimeve të kryera nga kontraktori, dhe këto do të paguhet në përputhje me nenin 50. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kushtet e veçanta, nuk do të bëhen shtesa në artikujt në fletore, përveç si rezultat i një ndryshimi në përputhje me <b>nenin 37</b> ose një dispozitë tjetër të kontratës që i jep <u>kontraktorit të drejtën për pagesë shtesë</u>;</p> <p><b>iv.</b> Mbikëqyrësi, kur kërkon të matet ndonjë pjesë e punimeve, duhet t'i japë njoftim të arsyeshëm kontraktorit që të marrë pjesë ose të dërgojë një agjent të kualifikuar për ta përfaqësuar atë. Kontraktuesi ose agjenti i tij do të ndihmojë mbikëqyrësin në kryerjen e një matjeje të tillë dhe do të japë të gjitha të dhënat e kërkuara nga mbikëqyrësi. Nëse kontraktori nuk merr pjesë, ose nuk e dërgon një agjent të tillë, matja e bërë nga mbikëqyrësi ose e miratuar prej tij do të jetë e detyrueshme për kontraktuesin;</p> <p><b>v.</b> Punimet do të maten neto, jo me zakone të përgjithshme apo lokale, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë.</p> <p><b>49.2.</b> Kur një artikull në kontratë tregohet si "i përkohshëm", shuma e përkohshme e caktuar për të nuk do të merret parasysh në llogaritjen e përqindjeve të përmendura në nenin 37.</p> <p>Referuar në Kushtet e Përgjithshme të kontratës neni 37.3.c citohet:<br/> <u>Nuk kërkohet asnjë urdhër administrativ për të rritur ose ulur sasinë e ndonjë pune kur kjo rritje ose ulje është rezultat i sasisë që tejkalon ose është më e vogël se sa është deklaruar në faturim ose në grafikun e çmimeve, si rezultat i matjes së parashikuar në nenin 49.</u></p> <p>- Me amendimin nr. 2, nr. 2147 prot., datë 14.04.2022, nga AK dhe OE, nënshkruhet ndryshimi i kontratës duke rishikuar çmimin e kontratës në vlerën 339,608 Euro pa TVSH ose 407,530 Euro me TVSH dhe afati i përfundimit të punimeve përcaktohet më datë 31.05.2022. Pra shtesa e vlerës së kontratës është në vlerën 42,900 euro pa TVSH (339,608 euro -296,708 euro) <u>ose 51,480 Euro me TVSH</u>, në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës së punimeve nr. 1962 prot., datë 14.04.2021. Referuar sa më sipër, konstatohet se nga AK është tjetërsuar lloji i kontratës dhe tipi i kontratës, nga Lump-Sum (çelësa në dorë) në kontratë me çmim njësie, duke realizuar një përfitim shtesë të kontraktorit në vlerën <b>51,480 Euro me TVSH</b>, të pa argumentuar dhe të pa mbështetur ligjërisht.</p> |
| <b>Kriteri:</b> | Programi: Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, 2014-2020. Titulli Projektit: 3C/ PARKU i ARTIT:   |

|                        |   |
|------------------------|---|
|                        | Cross-border exchange for the development of Cultural and Creative Industries", kodi 354. Rregullat e Prokurimit janë sipas direktivave të Komunitetit Evropian. PRAG (In line with EU public procurement regulations), kontratat për punë publike. VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" |
| <b>Ndikimi/Efekti:</b> | Rritje e vlerës së punimeve, në kundërshtim me kontratën  |
| <b>Shkaku:</b>         | Mos respektim i rregullave të kushteve të përgjithshme e të veçanta të kontratës dhe rregullave të PRAG (In line with EU public procurement regulations), kontratat për punë publike.   |
| <b>Rëndësia:</b>       | E Lartë   |
| <b>Rekomandimi:</b>    | - Ministria e Kulturës, të vlerësojnë e të analizojnë shtesën e kontratës në vlerën <b>51,480 Euro me TVSH</b> e cila rezulton e pa argumentuar, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga sipërmarrësi i punimeve "G.L" sh.p.k. |

### III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

#### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në dokumentacionit fizik dhe elektronik për procedurën e prokurimit me objekt "Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re", Tiranë, Faza II", viti 2022 me fond limit 155,008,461 lekë pa TVSH, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 21.06.2022 (anulluar) dhe në datën 15.08.2022, nuk janë argumentuar kriteret kualifikuese dhe një pjesë e tyre nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kriteret Kualifikuese janë konstatuar në kundërshtim me VKM nr. 425 datë 27.05.2020 "Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licence për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e Investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore" pika 17. Në pikën 3.5 të DST kërkohet që Operatori Ekonomik për realizimin e punimeve duhet të ketë 1 Arkitekt Peizazhi dhe 1 Inxhinier Pyjesh. Kjo kërkesë nuk është në përputhje me natyrën e kontratës, pasi në hapësirën ku do të zhvillohet projekti nuk është e nevojshme një arkitekt peizazhi, për shkak se projekti është i realizuar nga projektuesi dhe duhet vetëm të zbatohet nga ofertuesi me anë të inxhinierëve zbatues që ai disponon. Për sa i përket kërkesës për një inxhinier pyjesh nuk është e nevojshme dhe në përputhje me natyrën e prokurimit, për shkak se në ambientet e jashtme të Ministrisë së Kulturës nuk ka pyll, por thjesht një hapësirë e gjelbër. Në pikën 3.7. kërkohet që Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme (Licence, Kodi III.7.A për "Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotat"), e cila është në kundërshtim me pikën 17 të VKM nr. 425 datë 27.05.2020 për shkak se në hapësirën e gjelbër të Ministrisë së Kulturës, nuk ka as pyje e as kullota që ky kriter të ishte i domosdoshëm për realizimin e procedurës së prokurimit. (Më hollësisht trajtuar faqet nr. 9-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrin masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosija e çdo kriteri duhet të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

**Në vijimësi**

## B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

**1. Gjetje nga auditimi:** Midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe operatorit ekonomik "G.L." shpk është lidhur kontrata për punë publike nr. 1962 prot., datë 14.04.2021 me objekt "Rivitalizimi dhe përmirësimi i zonës së gjelbër – Parku i Artit, Ministria e Kulturës" me vlerën e kontratës 356,049 Euro me TVSH. Bazuar në Volumin 2, Seksioni 1, "Forma e Kontratës", në pikën 6 jepen të dhënat e kontratës e cila është e tipi *Lump-Sum*. Me shkresën nr. 20/1 prot., datë 12.04.2022 operatori ekonomik i është drejtuar mbikëqyrësit, ku kërkohen zëra të rinj punimesh me argumentin e mos parashikimit të zërave të nevojshëm në kontratë dhe përmirësime të projektit të propozuar nga kontraktori. Preventivi i rishikuar i punimeve dhe impakti financiar i volumit të shtuar është në masën 15% të vlerës fillestare në vlerën 5,493,869 lekë. Në kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Neni 49 – Matjet, 49.1. citohet se: *Për vlerësimin e kontratave të punës do të zbatohen metodat e mëposhtme:*

**a)** *Për kontratat me çelësa në dorë, shuma e detyrimit sipas kontratës do të përcaktohet në bazë të ndarjes së çmimit të përgjithshëm të kontratës, ose në bazë të një ndarjeje të shprehur si përqindje e çmimit të kontratës që korrespondon me fazat e përfunduara të punimeve. Kur artikujt shoqërohen me sasi, këto do të jenë sasi fikse për të cilat kontraktori ka paraqitur çmimin e tij të plotë dhe do të paguhet pavarësisht nga sasi të punës së kryer në të vërtetë.*

Me amendimin nr. 2, nr. 2147 prot., datë 14.04.2022, nga AK dhe OE, është nënshkruar ndryshimi i kontratës duke rishikuar çmimin dhe rritur vlerën e kontratës në shumën 339,608 Euro pa TVSH ose 407,530 Euro me TVSH dhe afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar data 31.05.2022. Pra shtesa e vlerës së kontratës është në shumën 42,900 euro pa TVSH (339,608 euro - 296,708 euro) ose 51,480 Euro me TVSH. Sa më sipër amendimi i kontratës është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës së punimeve nr. 1962 prot., datë 14.04.2021 pasi si, konstatohet është tjetërsuar lloji dhe tipi i kontratës, nga Lump-Sum (çelësa në dorë) në kontratë me çmim njësie, duke përfutur operatori ekonomik një vlerë shtesë prej **51,480 Euro me TVSH**, të pa ofertuar, argumentuar dhe të pa mbështetur ligjërisht. (*Më hollësisht trajtuar faqet nr. 9-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës, të vlerësojnë e të analizojnë shtesën e kontratës në vlerën **51,480 Euro me TVSH** e cila rezulton e pa argumentuar, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga sipërmarrësi i punimeve "G.L." sh.p.k.

**Menjëherë**

## C. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7/1 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, pika 1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2014 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i

*rekomandojmë* Titullarit të Ministrisë së Kulturës, t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, sipas kontratave respektive, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të nxjerrë vendime për marrjen e masave përkatëse dhe sanksioneve administrative:

**1.** Subjekti BOE "GL.A" shpk, përfaqësuar nga administrator z. F.SH., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me objekt: *“Rivitalizimi dhe përmirësimi i zonës së gjelbër – Parku i Artit, Ministria e Kulturës”*, datë 14.04.2021, për shtesën e kontratës e cila rezultoi e paargumentuar në vlerën 51,480 Euro me TVSH, e përfituar padrejtësisht nga kontraktori.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**